



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

Date 06.11.2025

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“PRODHIME GIZE DHE HEKURI ”, Procedurë e hapur e thjeshtuar - mallra, me afat sipas kërkesave të AK”

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,997,372 (Nje milion e nenteqind e nentedhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatedhjetë e dy) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkoder sha, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Specifikime teknike	Njësia	Sasia
1	Gradela gize 70x40	me menteshe	cope	40
2	Gradela gize 65x45	me menteshe	cope	36
3	Gradela gize 60x40	me menteshe	cope	35
4	Gradela gize 50x40	me menteshe	cope	40
5	Gradela gize 50x35	me menteshe	cope	40
6	Gradela gize 45x45	me menteshe	cope	26
7	Gradela gize 45x40	me menteshe	cope	40
8	Gradela gize 40x40	me menteshe	cope	6
9	Gradela gize 40x35	me menteshe	cope	33
10	Gradela gize 40x30	me menteshe	cope	32
11	Hekur betoni	me diameter 12mm-20mm	kg	400
12	Kapak gize fi 600 per ngarkesa nen 40 ton	me menteshe	Copë	22

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetë-deklarimit”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të jetë i siguruar për gjendjen aktuale të OE, për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate.

b. Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;

c. Listën e Çmimeve sipas Shtojcës 2.

Argumentimi: Kriteret e mësipërm (b, c) janë bazuar në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 15, “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”, pika 2.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 30 “Sigurimi i ofertës”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;” dhe pika 2: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë...”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023,2024 me një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit

te ketij prokurimi. **Kjo** Kërkese konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.1.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiar 2022, 2023, 2024 ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të jetë e madhe se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës...”bazuar në nenin 43 të VKM-në Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore kërkohet bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Bilancet për 3 vitet e fundit janë kërkuara bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe shërben për të njohur gjendjen financiare të operatorëve ekonomik ofertues

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën të vlefshme:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë,

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet. Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është gjykuar si i domosdoshëm, pasi kjo certifikatë garanton autoritetin kontraktor që operatorët ekonomik ofertues ofrojnë cilësinë në furnizimin e mallrave objekt kontrate.

2.2.3 Operatorët ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë raport testimi (analiza kimike të materialit gize), të kryera pranë një laborator të licensuar nga Drejtoria e Përgjithshme Standartizimeve pranë Keshillit të Ministrave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është konsideruar i domosdoshëm për kryerjen e analizave kimike të materialeve gize, pasi kemi të bëjmë me produkte si gradela gize, kapake pushtash për të cilat kërkohet të jenë material cilësor me fortesinë sipas standartave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimeve, duke garantuar qëndrueshmëri dhe siguri.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Deklaratë që merr përsipër transportin dhe lëvrimin e mallrave drejt ambienteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është vendosur për të shërbyer autoritetit kontraktor si garanci që operatori ekonomik fitues të garantojë sjelljen e mallit deri në magazinat e UK Shkoder.

Njesia Prokurimit

